Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/604
Datë: 13.10.2023

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 05.10.2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet dhe validohet** institucioni Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës me adresë: Rr. Sylejman Voshi nr.50 Prishtinë - Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 05.10.2023 deri 04.10.2026, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1 Ekspert Tatimor, Niveli V sipas KKK, lloji: Kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare (E) me 25 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në dy (2) grupe brenda vitit, më nga njëzetë e pesë (25) nxënës në një grup. Në total për një vit mund të regjistrojë 50 nxënës.

   1.2 Ekspert i Lartë Tatimor, Niveli V sipas KKK, lloji: Kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare (E) me 15 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në dy (2) grupe brenda vitit, më nga njëzetë e pesë (25) nxënës në një grup. Në total për një vit mund të regjistrojë 50 nxënës.

   1.3 Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare, niveli V sipas KKK, lloji: Kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare (E) me 18 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në një (1) grupe brenda vitit, me pesëdhjetë (50) nxënës në grup.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Institucioni Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës ka parashtruar në AKK kërkesë për akreditim dhe validim për kualifikimet Ekspert Tatimor, Ekspert i Lartë Tatimor, Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare. AKK bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka zhvilluar procedurat për vlerësim të institucionit sa i përket plotësimit të kritereve të përcaktuara nga AKK, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Pas realizimit të vizitës nga ekipet e ekspertëve në këtë institucion dhe trajtimit në detaje të dokumentacionit, ekipet e ekspertëve në raportet përfundimtar të hartuar kanë dhënë vlerësim pozitiv, dhe të njëjtat ia rekomanduan Këshillit Drejtues për vendimmarrje.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimeve; Raportin e vetëvlerësimit; Vizitat e ekipeve të ekspertëve në Institucioni Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës si dhe dokumente tjera shtesë.

Andaj, në bazë të kërkesës së Institucioni Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës për akreditim dhe validim si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipeve të ekspertëve të dhëna në Raportin e vlerësimit për akreditim dhe validim për institucionin aplikues, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës;
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim MUSTAFA

Kryetar i KD të AKK-së